



# BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Maj 2022

Programi Suedez SCPA merr pjesë në aktivitetin e ditës së Evropës.



Me 9 maj 2022, në krenimin e rritjen e kapaciteteve të Policisë së Ditës së Evropës në pedonalen e Shtetit Shqiptar për zbatimin e qytetit të Tiranës mori pjesë edhe filozofisë së policimit në komunitet Programi SCPA.

Qeveria Suedeze financon shumë programe, një ndër ta dhe SCPA, që mbështetin institucionet shqiptare për të rritur standardet në rrugën e Shqipërisë drejt BE-së.

Me pjesëmarrjen në këtë aktivitet Programi arriti të ndajë me publikun në mënyrë të drejtpërdrejtë punën që bën për

dhe angazhimin e saj për të ngritur një sistem vlerash evropiane brenda organizatës.



## AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Programi Suedez SCPA merr pjesë në aktivitetin e ditës së Evropës.
- ◆ Vizita monitoruese në komisaritet e DVP Vlorë
- ◆ Vizita vlerësuese në komisaratin e Durrësit dhe Krujës.
- ◆ Trajnim me grupin e dytë të OPP-ve të DVP Elbasan
- ◆ Trajnime për Dhunën në Familje me oficerët e policisë së DVP Dibër dhe Korçë
- ◆ Nxënësit e shkollave të Delvinës në ekspozitë me punimet me temë mbi dhunën
- ◆ NSPK-të për edukimin dhe punën me të rinjtë vazhdojnë punën për aktivitetet ndërgjegjësuese

### Vizita monitoruese në komisaritet e DVP Vlorë



Në datat 16-19 Maj 2022, ekipi i Ekspertëve të SCPA ka zhvilluar takime monitoruese në Komisaritet e Policisë të DVP Vlorë (komisariati i Vlorës, Himarës, Sarandës dhe Delvinës) për punën e deritanishme, për rezultatet e pritshme, si dhe gjendjen aktuale në lidhje me raportin përfundimtar lidhur me zbatimin e ndryshimeve që Këto takime vijnë, menjëherë përcaktohen në udhëzimin e pas takimeve fillestare që janë brendshëm të Drejtorit të DVP. Fillimisht, në të gjitha takimet u prezantuan disa prej së, ishin të pranishëm dhe Zv/ ndryshimeve që tashmë kanë Drejtori për Sigurinë Publike i cili filluar të zbatohen në terren. është caktuar me funksionin Shefat e komisariateve Drejtues të Grupit të Projektit informuan ekspertët e ekipit për për Zbatimin e Ndryshimeve si hapat e ndërmarrë deri më tani dhe Shefat e Komisariateve për të zbatuar ndryshimet e kryesore. Synimi i takimeve ishte parashikuara nga Urdhri i DP dhe të vlerësohej procesi i Udhëzimi i Brendshëm i DVP-së. ndryshimeve të kryer gjatë Ato shpjeguan në detaje disa këtyre muajve të fundit në nga ndryshimet e zbatuara. komisaritet e varësisë.

### Vizita vlerësuese në komisaritin e Durrësit dhe Krujës.



Gjatë muajit maj 2022, ekipi i ekspertëve të SCPA ka zhvilluar takime vlerësuese në komisaritin e Durrësit dhe Krujës, pjesë e DVP Durrës. Synimi i takimeve ishte të vlerësohej procesi i ndryshimeve të kryera gjatë këtyre muajve të fundit në komisaritet e varësisë.

Në Komisaritin e Krujës, meqenëse i gjithë niveli drejtues ishte rinovuar, u bë dhe një prezantim i shkurtër i projektit të ndryshimeve që është zbatuar në përputhje me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Me tej, u shpjeguan në detaje disa prej ndryshimeve që janë zbatuar në terren, jo vetëm në komisaritin e Krujës por edhe në komisaritet dhe postat e policisë që janë nën varësinë e DVP Durrës. Gjatë këtyre takimeve, u theksua se takimet vlerësuese kanë për qëllim të matin, sa të jetë e mundur, impaktin e ndryshimeve mbi punonjësit e policisë si dhe në cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit. Gjithashtu, u diskutua mbi konstatimin se është vërejtur tendenca e kalimit në rutinën e vjetër menjëherë sapo mbaron periudha e zbatimit të ndryshimeve. Në mënyrë që të shmanget fenomeni i kthimit në rutinën e vjetër të proceseve të punës, ekipi SCPA informoi bashkëbiseduesit se do të këtë vizita periodike në këto komisaritate. Këto vizita do të planifikohen dhe do të organizohen bashkërisht me sektorin e Policimit në Komunitet në DPPSH.

## Trajnim me grupin e dytë të OPP-ve të DVP Elbasan.



Në datën 20 Maj 2022, u zhvillua seminari në formë trajnimi në DVP Elbasan.

Në këtë seminar morën pjesë përkatësisht 17 oficerë të Patrullës së Përgjithshme nga të gjitha komisarariatet e varësisë të DVP Elbasan si dhe 2 Specialistë Rendi të komisarariatit të Elbasanit.

Ekipi i SCPA përbëhej nga eksperti vendor dhe koordinatori i SCPA. Objektivi i seminarit ishte forcimi i rolit të patrullës së përgjithshme sa u takon detyrave që mbart ky funksion dhe konsolidimin e zbatimit të tyre në praktikë në lidhje me ndryshimet që janë aplikuar në kuadër të projektit të ndryshimeve. Ky projekt ka i cili ka filluar fillimisht në DVP Pilot Elbasan është paraprirë nga një trajnim i të gjithë NSPK-SPZ-ve të vendit. Me pas trajnimi ka vazhduar me specialistët e rendit me funksion përgjegjës turni të OPP-ve dhe specialistët/operatorët e sallave të drejtimit dhe komandimit i cili do të vazhdojë me DVP -të e Jugut. Me fillimin e trajnimit me OPP-të përmbushet synimi që ndryshimet të zbatohen nga të gjitha strukturat pasi nëse preket një pjesë e sistemit detyrimisht influencohet i gjithë

sistemi. Gjatë seminarit bashkëbiseduesit trajtuan gjerësisht ndryshimet që janë duke u zbatuar me hyrjen në fuqi të përkrahjeve të reja të punës për Oficerët e Patrullës së Përgjithshme (OPP) dhe Ndhmës-Specialistëve të Policimit në Komunitet (NSPK), si dhe në detyrat e angazhimit të reja që këto ndryshime kanë sjellë jo vetëm për këtë strukturë por edhe për të gjithë zinxhirin e komandës.

Këto grup seminaresh synojnë:

- të rrisin kuptimin e kompetencave profesionale të Përgjegjësve të Turnit të Patrullës;
- të identifikojnë e forcojnë aftësitë e tyre individuale;
- të konsolidojnë më tej njohjen e detyrave të kësaj strukture;
- të identifikojnë format e mbështetjes për oficerët e patrullës së përgjithshme në raste emergjente si dhe ndarjen më të mirë të punës mes OPP dhe NSPK/SPZ.

## Nxenesit e shkollave të Delvines në ekspozitë me punimet me temë mbi dhunën



Në tremujorin e fundit, Shoqata "Jona" Sarandë, grantmarrëse në kuadër të raundit të 3-të të skemes së granteve ka organizuar një numër të madh aktivitetesh edukuese, dhe sensibilizuese kundër dhunës me bazë gjinore, me të rinj dhe mësues të shkollave të Delvines dhe Sarandes.

Takimet janë zhvilluar në kuadër të projektit "Rritja e bashkëpunimit komunitet - polici për parandalimin e dhunës në familje". Aktivitetet janë kryer në bashkëpunim me sektorin e policimit në komunitet, pranë

Gjate muajit Maj, nxënës të dy shkollave 9-vjeçare në Delvinë mbledhën në një ekspozitë punimet e tyre artistike me temë mbi dhunën. Djemtë dhe vajzat prezantuan më pas punimet dhe interpretuan konceptet e tyre mbi dhunën në familje dhe dhunën midis të rinjve, si dhe lexuan esetë e përgatitura me këtë rast. Motoja e aktivitetit ishte "Dhuna është problemi, dhuna nuk është zgjidhja".



## Trainime për Dhunën në Familje me oficerët e policisë së DVP Dibër dhe Korçë



Gjatë muajit Maj 2022, uzhvillua familje.

trajnimi me temë "Ndryshimet ligjore në adresimin e dhunës në familje" me punonjës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe Korçë.

Ky trajnim organizohet nga programi SCPA në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

51 oficerë policie të DVP-së Korçë, kryesisht ndihmës specialistë të policimit në komunitet dhe specialistë të krimeve në komisaritet në varësi si dhe 25 oficerë policie të DVP-së Dibër, u trajnuan mbi

ndryshimet dhe përmirësimet për periudhën 2018-2021 të kuadrit ligjor mbi dhunën në

Qëllimi i trainimit ishte rritja e aftësive të punonjësve të policisë së shtetit për të kryer vlerësime të strukturuar të rrezikut dhe zbatimi i dispozitave

ligjore specifike të përfshira së kohët e fundit në ligjin për DhF.

Procedurat e vlerësimit të rrezikut synojnë të ndihmojnë

punonjësit e policisë që të analizojnë me më shumë objektivizëm situata konkrete si dhe të identifikojnë nivelin e rrezikut aktual për rritjen e sigurisë së viktimave të DHF dhe DHBGJ.

## NSPK-të për edukimin dhe punën me të rinjtë vazhdojnë punën për aktivitetet ndërgjegjëse



Nëpërmjet forumit online në internet, të ndërtuar posaçërisht për komunikimin e NSPK-ve për edukimin dhe punën me të rinjtë, programi SCPA në bashkëpunim me sektorin e PK informohen saktësisht për aktivitetet e ndryshme të organizuara në çdo DVP.

Në periudhën e fundit gjashtë mujore deri në fund të muajit Maj 2022, janë zhvilluar më shumë se 205 aktivitete ndërgjegjëse në shkolla të ndryshme dhe janë postuar 367 foto për të ilustruar aktivitetet e tyre. Në pararojë janë NSPK-të e komisariateve Kukës, Durrës, Lezhë, Cerrik, Elbasan, Mirdite dhe Fier.

Programi ka arritur në përfundimin se forumi për NSPK-të në Facebook vazhdon të jete një instrument i suksesshëm dhe shumica e pjesëmarrësve janë shumë aktivë me postimet dhe shkëmbimin e informacionit. Ky forum, tashmë ia ka arritur qëllimit të tij për të ndërtuar një frymë të fortë ekipi dhe për të nxitur komunikimin dhe shkëmbimin e përvojave në mesin e NSPK-ve për edukimin dhe punën me të rinjtë dhe ne synojmë ta rrisim atë gjatë periudhës në vijim.

Për me tepër shiko:

<https://www.facebook.com/groups/2127903213928271>